


Statistikat e Pagave

Tremujori III / 2023

Tiranë, 11 Dhjetor 2023: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të tretë 2023, është 71.486 lekë, duke u rritur me 16 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Fig. 1 Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri (lekë) ¹




Gjatë tremujorit të tretë 2023, aktivitetet ekonomike që ofrojnë pagë mesatare mujore bruto, më të lartë se paga

mesatare në nivel kombëtar, janë Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit dhe Informacioni dhe Komunikacioni.

Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, gjatë tremujorit të tretë 2023 paga mesatare bruto për grup-aktivitetin e Administratës publike dhe mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm; arsimit; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale, ka rritjen më të madhe prej 18,6 %, ndërsa rritjen më të vogël e ka grup-aktiviteti Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit prej 11,4 %.


¹ Shpërblimet dhe shtesat mbi pagë janë një pjesë e pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, të cilat në fund të çdo gjashtëmujori rrisin ndjeshëm pagën mesatare mujore bruto (shih shënimin metodologjik).

Fig. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteteve ekonomike (lekë)



Gjatë tremujorit të tretë 2023, grup-profesionet e “Manaxherëve, Ligjvënësve, Nëpunësve të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorëve ekzekutivë” dhe “Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)”, ofrojnë pagat mesatare mujore bruto më të larta, krahasuar me pagën mesatare në nivel kombëtar.

Fig. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve



Tab. 1 Paga mesatare mujore bruto dhe paga minimale e miratuar

Përshkrimi	III/20	IV/20	I/21	II/21	III/21	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë	52.815	54.951	56.019	56.710	56.435	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror	64.334	66.479	67.769	68.196	67.538	70.531	67.045	68.245	70.593	74.450	73.205	82.207	84.318
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin privat	47.486	49.440	50.330	51.247	51.305	54.482	55.638	57.327	57.613	62.198	60.943	65.901	65.975
Paga minimale e miratuar	26.000	26.000	30.000	30.000	30.000	30.000	30.000	32.000	32.000	34.000	34.000	40.000	40.000

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-aktiviteteve ekonomike

NVE Rev2 (seksion)	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev2	III/20	IV/20	I/21	II/21	III/21	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23
Gjithsej		52.815	54.951	56.019	56.710	56.435	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	33.500	32.474	35.256	35.887	35.627	35.881	38.445	40.044	41.205	42.428	43.903	47.068	47.648
B,C,D,E	Industria gjithsej	45.264	45.954	48.060	48.093	48.228	51.104	50.682	53.266	53.551	57.079	57.720	61.117	61.570
F	Ndërtimi	41.845	41.532	42.519	42.505	43.433	44.949	46.953	48.210	49.062	51.025	51.465	56.117	57.080
G,H,I	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	39.051	41.148	42.516	43.034	43.491	45.988	46.987	48.630	49.434	53.178	52.436	56.758	57.328
J	Informacioni dhe komunikacioni	76.763	82.851	80.707	88.345	85.232	90.707	101.564	96.789	93.910	103.520	103.215	112.114	105.585
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	102.262	115.189	101.521	120.571	108.646	122.106	114.334	130.872	119.135	142.141	119.206	149.091	132.686
L,M,N	Aktivitete të pasurive të paluajtshme; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	60.333	62.505	61.745	61.392	62.707	66.055	66.975	67.129	68.768	73.543	72.662	76.444	79.300
O,P,Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	64.591	66.435	68.385	68.341	68.264	70.694	68.048	68.389	71.675	75.059	73.201	82.319	84.992
R,S,T,U	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi	56.921	60.736	60.532	61.172	60.088	64.854	62.142	64.061	65.024	69.168	66.332	71.747	72.661

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve ekonomike

Grup-profesionet sipas ISCO-08	III/20	IV/20	I/21	II/21	III/21	IV/21	I/22	II/22	III/22	IV/22	I/23	II/23	III/23
Gjithsej	52.815	54.951	56.019	56.710	56.435	59.565	59.242	60.666	61.613	66.014	64.706	70.905	71.486
Manaxherë, Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	93.738	99.259	96.836	98.823	95.959	102.304	102.853	102.156	100.256	109.465	104.483	116.627	116.176
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	71.325	74.172	75.158	76.375	76.460	79.476	78.288	79.925	82.374	86.542	85.007	92.566	93.963
Teknikë dhe specialistë në zbatim	59.830	61.573	63.031	63.619	64.007	67.711	66.377	67.437	68.749	72.863	71.331	77.127	78.481
Nëpunësit	56.929	60.633	58.762	58.871	58.539	62.410	62.406	63.363	63.544	69.219	67.326	71.363	73.021
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	39.823	41.186	42.584	43.108	43.032	45.157	44.626	45.751	46.732	50.279	49.413	54.678	54.942
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	32.882	32.753	35.073	35.580	36.021	36.691	37.929	39.832	40.615	42.915	42.646	47.413	47.620
Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to	36.759	37.346	38.785	39.522	39.728	41.602	41.803	43.810	44.515	47.130	47.192	51.460	51.728
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	36.622	37.999	38.995	39.632	40.241	42.514	42.760	45.495	46.253	49.272	48.958	52.924	53.223
Punëtorë (Profesione elementare)	31.898	31.874	32.454	34.295	34.747	35.097	36.281	38.620	39.402	41.572	41.387	46.387	47.029
Forcat e armatosura	63.662	64.041	64.495	65.705	65.232	65.287	70.493	65.359	77.362	78.837	79.568	86.236	86.454

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i të dhënave për pagat përmbajnë të dhëna të detajuara për nivelin e pagave, shpërndarjes dhe ndryshimin e tyre përgjatë tremujorëve. Këto statistika ofrojnë një mundësi për të krahasuar pagat në industri të ndryshme dhe në grup-profesione të ndryshme. Statistikat mbi pagat janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë për monitorimin e treguesve ekonomikë që përdoren nga politikë-bërësit, punëdhënësit dhe sindikatat për të vlerësuar kushtet e kërkesës dhe të ofertës për punë.

Baza ligjore

- Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare;
- Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026.
- Memorandumi i Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Burimi i informacionit

Burimi i të dhënave mbi pagat është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bazë të memorandumit të bashkëpunimit i dërgon INSTAT-it, të dhënat nga Listëpagesa (E-SIG 025).

Ky formular shërben për deklarin e tre llojeve të detyrimeve tatimore :

- Të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore,
- Të Kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore,
- Të Ardhurave nga Punësimi për punëmarrësit.

Variablat e skedarit janë tre lloje: variablat e skedarit origjinal nga DPT, variabla shtesë nga INSTAT dhe variabla të derivuar. Dy variablat kryesorë të interesit në këtë skedar janë Numri i punonjësve dhe Paga bruto paguar punëmarrësit.

Përkufizime

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr mesatarisht një i punësuar për punën që ka kryer në një muaj. Ajo përbëhet nga:

- Paga bazë për punën e kryer
- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.)
- Shpërblime

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Paga minimale mujore - është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontribues me pagë në sektorin e Bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit - konsiderohen të gjithë të punësuarit me pagë të deklaruar nga fermerat/ndërmarrjet bujqësore të rregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Klasifikime

- Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev. 2, si më poshtë:

NVE Rev.2 (Seksioni)	Përshkrimi
A	Bujqësia, pyjet, peshkimi
B	Industria nxjerrëse
C	Përpunimi
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomidimi dhe shërbimi ushqimor
J	Informacioni dhe komunikacioni
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L	Aktivitete të pasurive të paluajtëshme
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
O	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm
P	Arsimi
Q	Shëndetsia dhe aktivitete të punës sociale
R	Arte, argëtim dhe çlodhje
S	Aktivitete të tjera shërbimi
T	Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet
U	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

- Klasifikimi i profesioneve është bërë sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Profesioneve, ISCO-08, si më poshtë:

ISCO_08	Përshkrimi
1.	Manaxher
2.	Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)
3.	Teknikë dhe specialistë në zbatim
4.	Nëpunësit
5.	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve
6.	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit
7.	Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to
8.	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve
9.	Punëtorë (Profesione elementare)
0.	Forcat e Armatosura